



Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	08 - 09	2022	2	viti god. year.
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Hr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK	5235	2022	119	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.657/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.657/2022 të datës 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë:

në Komunë të Prishtinës kundër organit të punësimit Gjykata Supreme në Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës ", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.657/2022, e datës 26.07.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në Fuqi Vendimi KA.Nr. 23/2022 të datës 27.06.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar Gjykatës Supreme të Kosovës, me datë 26.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 4299/2022, kundër Vendimit me numër protokollit 1303 të datës 27.06.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.08.2022, ka proceduar tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa me datën 15.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4299/2022 të datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rekomandim nr. Protokollit 66/2022 i datës 29.03.2022 për harmonizim të pagës me pozitën e zyrtares ligjore për punonjësen

Diplomë Kolegjit AAB, e datës 02.07.2019 Nr.842/19; Kërkesë e datës 06.12.2019 për avancim; Kërkesë nr. 73/2020 e datës 05.03.2020 për avancim; E-mail -Njoftim i datës 22.07.2021 nga Zyrtarja e personelit; E-mail i datës 21.07.2021 prej U.D Drejtor i Departamentit të Administratës së Përgjithshme; Akt emërimi i datës 02.04.2012; Raporti mbi vlerësimin e punës të punëtorit i datës 20.12.2012; Formulari për vlerësimin në punës i datës 10.01.2022; Formulari për vlerësimin në punës i datës 18.01.2021; Vendimi nr.03/1067 i datës 20.05.2022; Ankesë e datës 10.06.2022 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Vendimi me nr.1303 i datës 27.06.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 15.08.2022 nga Këshilli Gjyqësor të Kosovës, fletë kthesë postare e datës 01.07.2022; Listë nga libri i pranimit, që lidhet me vendimin me nr.protokollit 03/1067 i nënshkruar me datë 25.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 01.04.2012 është e punësuar në pozitën "Sekretare Juridike", me koeficient 6 në Gjykatën Supreme, e cila me datë 25.05.2022 ka pranuar Vendimin Nr.03/1067 nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilin i është refuzuar kërkesa lidhur me harmonizimin e pozitës dhe pagave të sekretares juridike nga koeficienti 6, në pozitën "Zyrtar ligjor 1", me koeficient 7, për shkak që nuk ka diplomë adekuate.

Lidhur me këtë ankuesja e pa kënaqur me Vendimin Nr.03/1067 e datës 25.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 10.06.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me pretendime ankimore se brenda organizimit aktual të gjykatës ka pasur lëvizje të nën punëve civil për avancim dhe e cila kërkon që të avancohet nga pozita aktuale "Sekretare Juridike", në pozita të lira në Gjykatën Supreme, e cila thekson se ka përfunduar Fakultetin për Administratë Publike, në korrik të vitit 2019. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me datë 27.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 1303, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses, si të pa bazuar.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që të bëhet harmonizimi i koeficientit nga gjashtë (6) në shtatë (7) si dhe të behët avancimi në një pozitë ekuivalente.

Duke marr parasysh që për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk aplikohet Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, por është i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se neni 27 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcakton se: *“Avancimi nga një pozitë më e ultë në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ultë në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të:(1.4) kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale”*, mbi këtë bazë, kalimi në pozita të ndryshme bëhet në pajtim me këtë dispozite ligjore, andaj në këtë kuptim edhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrës së Vendimit KA.Nr. 23/2022 të datës 27.06.2022 më të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses, ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, sepse ankuesja në bazë të dokumentacionit të ofruar posedon Diplomë me Nr. 842/19 të datës 02.07.2019 të lëshuar nga Kolegji AAB përmes të cilët dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në programin Administratë Publike, duke marr titullin Baçelor i Arteve në Administratë Publike dhe e njëjta nuk ndërlidhet me kriterin e arsimimit/kualifikimit që kërkohet për pozitën „Zyrtar Ligjor” sepse për këtë pozitë fusha apo arsimimi i kërkuar është Diplome nga Fakulteti Juridik.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sa i përket çështjes së koeficienteve, konstaton se neni 7 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili përcakton: *“Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat”*, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ligjërisht ngritja e koeficienteve për nëpunësit civil, mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet dëshmohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa, kështu përderisa nuk ka planifikim buxhetit apo nuk ka kërkesë nga institucioni ku nëpunësi civil është duke e ushtruar pozitën tek institucionet gjegjëse, atëherë përderisa nuk plotësohen kushtet e tilla ligjore, nëpunësi civil paguhet me pagë siç është përcaktuar në aktin e emërimit me të cilin ka themeluar marrëdhënien e tij të punës, siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 9 paragrafin 1 përcakton se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”*, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.Nr. 23/2022 të datës 27.06.2022 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.657/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ;
- Arkivot të KPMSHCK-së.

